



NË DUKJE NË YOUTUBE: FRETËR QË KUJDESEN PËR MENDJEN, TRUPIN E SHPIRTIN

Si të rrimë në kontakt me popullin e Hyjit gjatë karantinës? Fretërit janë angazhuar për të ideuar nisma online me një larmi të gjerë përmbajtjesh multimediale. Vetëm në YouTube mund të gjendet një numër i madh videosh françeskane me metoda, stile, gjuhë dhe argumente të ndryshme që i ndihmojnë personat të kujdesen për personin e tyre, në tërësinë e tij: mendje, trup e shpirt. Ja disa prej tyre.

Fretërit e Singaporit paraqesin [një seri videosh](#) të përditshme në anglisht mes të cilave "Si ta jetojmë Paqen e Pashkëve në kohë të vështira", "Çelësi i Lumturisë", "Dashuria, Mirësjellja dhe Sakrifika". Ndërsa, nga ana tjetër e botës, fretërit e Provincës së Toskanës, kanë hedhur një seri "[Pilulash Përshpirtërie](#)" në gjuhën italiane.

[Fretërit francezë dhe belgë](#) kanë realizuar një seri me rastin e 5-vjetorit të Enciklikës së Papës Françesku, Laudato Si'. Reflektime mbi "monde d'après" – bota përtej së tashmes, bota që duam të ndërtojmë.

Duke kaluar nga Parisi në Los Anxheles, mund të shohim fretërit e Famullisë së Sh. Simonit e Judës në "[Franciscan Spiritual Moments](#)" (Momente Shpirtërore Françeskane). Flasin për shenjtërit françeskanë dhe tregojnë histori françeskane të njohura si *Hareja e Përsosur*, *Françesku që u predikon zogjve*, *Françesku që merr varrët...* duke paraqitur edhe reflektime interesante.

Duke shkuar drejt veriut në Vankuver, në Kanada, famullia françeskane e Sh. Jozefit Punëtor ka filluar të paraqesë "[Wellness Wednesdays](#)" (Të mërkurat e Mirëqenies), një stërvitje e përjavshme intensive prej 20 minutash për gjithë trupin. Programi i ushtrimeve, me fretër dhe anëtarë të ndryshëm të familjes famullitare, synon të nxisë shëndetin fizik, mendor e shpirtëror, me përhapje lokale dhe ndërkombëtare.

Të mos harrojmë se në periudha stresuese ushqimi dhe shoqëria e mirë janë me të vërtetë të rëndësishme! Tre fretër polakë kanë regjistruar një video me programet e tyre për të rinj që u mësojnë fëmijëve se si të gatuajnë [spagetat bolonjeze](#). Edhe nëse nuk e kupton polonishten, videot françeskane për ushqimin të fretërve Euzebiusz, Kryspin dhe Tymoteusz me të vërtetë ngrejnë lart moralin. Nëse dëshiron të provosh disa receta më angazhuese, atëherë shiko [Fr. Ángel Ramón di Valencia](#), Spanjë. Fr. Ángel është një frater me zemër të madhe, që e do ushqimin dhe është një kuzhinier i shkëlqyeshëm. Bashkëndan receta dhe histori të ndryshme tradicionale, mes të cilave supën kastiliane, pastičinit (magdalenas conventuales) dhe patatet e lagështa me lepur.

Vizito kanalin [YouTube OFM](#) për të parë këto dhe videot e ardhshme.

LAJME TË TJERA

LIBRA TË RINJ

NGJARJE ONLINE

Francisco de Asís,

EL BUENAGENTE



Francisco de Asís, el Buenagente: Një album i ri muzikor

Muzikanti Jesus Vicente Morales Escala, ka publikuar një album të ri në nder të Shën Françeskut të Asizit. Është pjesë e "Projektit Buenagente" që ka qëllim të zhvillojë në shkollat françeskane të Provincës së Zojës së Papërlyer (Spanjë), një mënyrë të re të të jetuarit freskinë e Ungjillit.

Muzika është e disponueshme në platformat e ndryshme muzikore, çdo shkarkim dhe streaming do të shkojë në ndihmë të misionëve françeskane të Vikariatit të Rekuenës në Peru: colegiosfranciscanos.org/buenagente

Revolucioni *Laudato Si'*

Revolucioni *Laudato Si'* është një fushatë globale objektivi i së cilës është të inkurajojë dhe nxisë kthimin e tërësishëm të ekologjisë, pra një ekologji mjedisore, ekonomike dhe shoqërore. Dimensionet njerëzore dhe shoqërore janë në qendër të fushatës sonë, sepse duam që vlerat e drejtësisë shoqërore dhe mjedisore, kujdesi dhe respekti për botën e krijuar dhe solidariteti ndërbreznor të bëjnë pjesë në jetën tonë të përditshme.

Vizitoni [sitin Web](#) dhe shikoni video-mesazhin e Fr. Michael Perry, Ministër Gjeneral, për Revolucionin *Laudato Si'*:

English - Español - Italiano
Deutsch - Français - Hrvatski
Polski - Português - 한국어
Tiếng Việt - العربية
Bahasa Indonesia - 日本語

Pietro Messa

Francesco profeta
La costruzione di un carisma



PIETRO MESSA OFM, *Francesco profeta. La costruzione di un carisma (Frangësku profet. Ndërtimi i një karizme)*. Viella, Romë 2020, faqe 224.

Me kalimin e kohës Frangësku i Asizit u njoh si profet, pra si person i pajisur me dhurata profetike.

Tema e profecisë, që përfshin jo vetëm fetarinë, por edhe fusha të ndryshme të jetës personale e shoqërore, gjatë viteve është shqyrtuar nga historianë të besimeve dhe të krishterimit nën aspekte të ndryshme, derisa të thellohej dhe studiohej në përmbajtjet, kontekstet specifike dhe rezultatet e saj. Duke konsideruar rezultatet e arritura dhe metodat e ndryshme të afrimit, është interesante të studiohet Frangësku i Asizit dhe karizma profetike që i atribuohet atij.

ERNESTO FERRERO, *Francesco e il Sultano (Frangësku dhe Sulltani)*, Einaudi, Torino 2019, faqe 208.

Frangësku i Asizit ishte tridhjetë e shtatë vjeç kur mori anijen në Ankona drejt Tokës së Shenjtë. Së bashku me fratin e besuar Illuminatin la përkohësisht një Urdhër tashmë të turbulluar prej kundërshtive të para dhe që ende nuk kishte një Rregull të miratuar nga papa.

Me hapin e një romani aventure dhe saktësinë e një biografie, *Frangësku dhe Sulltani* e shndërron tërësinë e tregimeve përrallorë që i quajmë Histori në një ngjarje që vazhdon të na përkasë nga afër.

ERNESTO FERRERO
FRANCESCO E IL SULTANO



KURSE VERORE FRANGËSKANE 2020 TË OFRUARA ONLINE NGA FRANCISCAN SCHOOL OF THEOLOGY (FST)

Në muajin korrik, FST propozon mësimet verore të Formimit të Përhershëm 2020 online, duke u dhënë studentëve mundësinë të regjistrohen dhe të frekuentojnë programin veror nga çdo anë e botës! Do të ketë katër sesione për të shqyrtuar tema të ndryshme. Argumentet: (1) Frangësku, përvoja e tij shpirtërore, interpretimi i tij ungjillor dhe jeta bashkëkohore; (2) Shkrimet e shën Françeskut; (3) Vizioni frangëskan i Gjon Duns Skotit; (4) Përshpirtëria e Pranisë me personat në fill të vdekjes.

Regjistrimi në kurse duhet të bëhet brenda 26 qershorit 2020.

Për më shumë informacione:

www.fst.edu

[Poster](#) - [Registration](#)



TOKA E SHENJTË: DRITARE MBI LINDJEN E MESME

'Dritare mbi Lindjen e Mesme' është hapësira e re virtuale nëpërmjet së cilës Terrasanta.net dhe Komisarjati i Tokës së Shenjtë i Italisë Veriore dëshirojnë të paraqesin thellime mbi Lindjen e Mesme dhe Tokat Biblike.

Çdo javë, për të diskutuar mbi një argument specifik, do të marrin pjesë të ftuar ekspertë në transmetim të drejtpërdrejtë në:

Facebook: [Terrasanta.net](https://www.facebook.com/Terrasanta.net) -

[Francescani di Terra Santa](https://www.facebook.com/Francescani di Terra Santa)

YouTube: [Edizioni Terra Santa](https://www.youtube.com/Edizioni Terra Santa)